



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Ndërmarrja Radiodifuzive Publike "Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup"

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- nuk janë miratuar aktet strategjike, planifikuese, programore dhe nënligjore;
- dispozita të pasakta në aktin për sistematizimin e një pjesës së kërkesave dhe përshkrimit të detyrave të punës dhe akteve të pa harmonizuara për llogaritjen e pagave me dispozitat ligjore në fuqi;
- nuk është vendosur njësia për revizionin e brendshëm;
- regjistrimi jo i plotë i zbatuar i mjeteve dhe detyrimeve;
- monitorim i pavendosur i masave të ndërmarrja për arkëtimin e kërkesave më të vjetra se pesë vjet dhe
- parregullsi në planifikimin, dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe realizimin e tyre.

Rekomandimet kyçe:

- miratimi i akteve strategjike, planifikuese, programore dhe nënligjore;
- saktësimi i kërkesave dhe përshtatjes së përshkrimit të detyrave në aktin për sistematizim me kompetencat dhe aktivitetet të cilat kryen, si dhe harmonizimi i akteve për llogaritjen e pagës me rregullat ligjore;
- vendosja e revizionit të brendshëm;
- zbatimi i regjistrimit të plotë të mjeteve dhe detyrimeve dhe harmonizimi i kontabilitetit me gjendjen faktike;
- përditësimi i evidencës për monitorimin e kërkesave dhe marrjen e veprimeve ligjore në kohë për kërkesat e papaguar nga komitentët dhe
- përmirësimin e planifikimit, mënyrën e zbatimit të procedurave për prokurime publik,
- si dhe nevojën për dispozita të sakta në kontratat për mënyrën e realizimit të prokurimit dhe pagesave.

Mendimi i dhënë *:



Mendim me rezervë për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Dobësitë kyçe të sistemit: /

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga personi i autorizuar në NRP TVM janë marrë vërejtje të draft-raportit të autorizuar shtetëror numër 19-985/3 prej 30.05.2022.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Pjesa më e madhe e vërejtjeve paraqet njoftim për masat e ndërmarrja, arsyetim për shkak gjendjeve, një vërejtje pjesërisht është pranuar, ndërsa një vërejtje nuk është pranuar për shkak mos dorëzimit të dëshmive.

*



pozitive



me rezervë



të pavolitshëm,



të përmbajtur